- 4.3. Realizimi i të hyrave për vitin 2017 ishte 71.679,50€, kurse realizimi i të hyrave në vitin 2018 ishin 76.644,00€, në vitin 2018 realizimi i të hyrave ishte më i lartë për 6,48%,
- 4.4. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për vitin 2018 ka qenë mesatarisht 6,33%. Në vitin 2017 pjesëmarrja ka qenë 7,63%, në vitin 2018 ka pasur një ulje të letë të pjesëmarrjes e cila ka qenë 1,30%.

## **Çështja 5- Kushtëzimi i pagesës së taksës në kërkesa**

Qellimi i këtijë Udhëzimi Administrativ është që të definojë dhe përcaktojë shërbimet komunale të cilat



Komuna mund ti kushtëzojë tatimpaguesit për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë.

#### **E Gjetura:**

- Udhëzimit Administrativ 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së taksës për certifikata të pronës, neni 7 që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj kërkuesve për dhënjën e certifikatave mbi pronë,
- Gjatë rishikimit në të gjitha kërkesat ishte respektuar kushtëzimi i pagesës së taksës për dhënjën e certifikatave
- Në bazë të Rregullorës komunale çdo kërkesë për dhënjën e një certifikate, kërkohet të paguhet taksa një euro.
- Gjatë rishikimit të raportit të punës, në pranimin e kërkesave për vitin 2018, ishin 8.602 kërkesa të evidentuara, kurse në raportin mujor dhe vjetor të lëndëve, referenti për lëshimin e certifikatave, nuk i kishte të evidentuar numrin e kërkesave në raport, i kishte të evidentuar vetëm shumën totale të certifikatave dhe kopjes së planit.
- Me anë të një kërkesë, janë lëshuar dhe paguar në arkë më shumë se dy certifikata mbi pronë, të cilat ishin të regjistruara në sistem.
- Konstatohet se në arkë në shumtën e rasteve është kryer pagesa e taksës për certifikata pa kërkesë, e cila kërkohet çdo lëndë të jetë e paisur me vertetim për kushtëzim, me një kërkesë për një certifikat, të cilët pagesa e taksës bëhet në arkë një(1) euro për kërkesë dhe katër(4) euro për certifikat.

Pagesa e taksës për certifikat më shumë se tri(3) e ma shumë certifikata, kërkohet të kryhet në bank.

#### **Menaxhimi financiar dhe kontrolli**

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave në Drejtorit përkatëse. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, burimet njerëzore dhe detyrimet.

#### **KONKLuzioni**

Për menaxhimin financiar dhe kontrollin Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash përfshirë të hyrat, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë zbatimi i plotë i procedurave të detyrimit, sidomos te fusha e të hyrave, ku në disa raste Drejtorit kan dështuar t'i respektoj në plotësi kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve në inkasimin e të hyrave. Gjithashtu Drejtorit duhen të kenë në konsiderat në shtimin e kontrollit në kategorinë e të hyrave, dhe pagesën me kohë të obligimeve. Sfidë e Drejtorive mbetet edhe menaxhimi dhe raportimi sa ma i drejt i të hyrave.

#### **REKOMANDIMET:**

##### **REKOMANDIMI – 1**

- Rekomandojm që Drejtorit e audituar të sigurojë se performanca e inkasimit monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike nga drejtoritë përkatëse dhe zyra e financave, dhe që ky rishikim adreson me kohë barrierat që letësojnë inkasimin e të hyrave sipas planit.

##### **REKOMANDIMI- 2**

- Rekomandojm që të sigurohet që kushtëzimi i pagesës së tatimit në pronë të shërbimeve të bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2011.

#### **REKOMANDIMI - 3**

- Rekomandojm drejtorin e audituar duhet të sigurojë që plani i të hyrave është i bazuar në analiza dhe vlerësime të sakta nga njësit përkatëse që i grumbullojnë ato, për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre.

#### **REKOMANDIMI – 4**

- Rekomandojm njësit punuese që bëjnë evidentimin e pacienteve në librin e protokolit të bëjnë krahasimin e participimit në librin e protokolit.

#### **REKOMANDIMI – 5**

- Rekomandojm që bllok dëftesat që nuk janë dorëzuar në zyrën e pranimi, dhe nuk është kryer inkasimi në arkë, të kërkohen, në të ardhmen të dorëzohen me kohë, në zyrën e pranimi të bllok dëftesave.

#### **REKOMANDIMI - 6**

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar të aplikoj masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhat e mëhershme.

#### **REKOMANDIMI - 7**

- Rekomandojm që të respektohet Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 576, (Neni 19) çdo kërkesë të definohet në nxerjen dhe pagesën e certifikates.

#### **REKOMANDIMI - 8**

- Rekomandojm që menaxhmenti i entiteteve të audituar në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performancën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmenti i lartë i komunës (në tekstin e mëtejshëm "llogaridhënia").

### **PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):**

#### **FUSHËVEPRIMI:**

Në bazë të Kërkesës të dates 21.02.2019, lëshuar nga Kryetari i Komunës që të bëhet auditimi ad-hoc për të hyrat vetanake në Drejtorit të cekur më lartë, për periudhën janar – Dhjetor vitit 2018, dhe për periudhën e parë të vitit 2019.

#### **OBJEKTIVI:**

1. Realizimi i të hyrave vetanake

## 1.2. EMËRTIMI I AUDITIMIT:

Auditimi i Brendshëm në Drejtorin Komunale të Arsimit.

## TË GJETURAT:

### 4. REZULTATET

Objektivi kryesor i auditimit

Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të tarifave nga participimi dhe arkëtimi i të hyrave vetanake në planifikimin ton të auditimit kemi parapa të auditojmë sistemin planifikimit të të hyrave vetanake, përshtatshmëria e arkëtimeve me tarifat e miratuara dhe grumbullimi i të hyrave vetjake, dhe objektivat e kontrollit të sistemit të dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rreziku dhe efikasiteti dhe efektiviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objektivi ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin dhe kontrollin e këtij sistemi për të i ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mos funksionimin e kontrollit në këtë drejtim.

**4.1. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave dhe shpenzimeve , ekziston dhe funksionon.**

#### 4.1.1. Grumbullimi i të hyrave vetanake

- a) Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar si pas dispozitave.

Drejtoria Komunale për Arsim realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake sipa Rregullores komunale për tarifat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale nr 576 date 28.02.2017 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

Pagesat vijuese për vijimin dhe përfundimin e Arsimit dhe aftësimin për të rritur dhe çerdhe të fëmijëve:

| Nr.Re n. | EMËRTIMI                                                   | VLERA   |
|----------|------------------------------------------------------------|---------|
| 1        | Për regjistrim të vitit për një klasë në shumë prej        | 100.00€ |
| 2        | Për praktik profesionale në vlerë prej                     | 50.00€  |
| 3        | Për provim diferencial(plotësues) në vlerë prej            | 10.00€  |
| 4        | Për provimet përfundimtare të klasës,Çertifikatën në vlerë | 30,00€  |
| 5        | Për diplomë të përfundimit të shkollimit                   | 20,00€  |
| 6        | Për pagesa mujore për fëmijë në çerdhe në vlerë            | 30,00€  |
| 7        | Për pagesa mujore për një fëmijë në çerdhe gjysmë dite     | 15,00€  |
| 8        | Për Diploma duplikat                                       | 1,00€   |
| 9        | Për Dëftesa duplikat                                       | 0,50€   |

E gjetura

Gjatë rishikimit të hyra kishte vetëm nga pagesat mujore për fëmijë në çerdhe dhe nga taksat administrative për fletëkërkesa, të hyra tjera nuk kishte, në tabelën si më lartë.

Regjistrimi i të dhënave për të hyrat e inkasuara nga participimet bëhet në mënyrë manuale. Kjo për shkak se DKA-ja nuk posedojnë ndonjë softuer për menaxhimin e tyre. Të dhënat manuale ekzistuese menaxhohen në mënyrë të rregullt, janë mbajtur regjistra të brendshëm në lidhje me të hyrat e mbledhura, për qëllime të raportimit. Për te cilat ne mendojmë se vlera e mostrave është sipas planit vjetor i mjaftueshëm për të krijuar një opinion lidhur me funksionimin e sistemit dhe përshtatshmërisë.

Bazuar në informacionet e shpalosura dhe mostrat nga evidenca dhe raporti vjetor të vitit 2018 të hyrat ishin 9.356,00€, kurse planifikimi ishte 25.027,00€, Realizimi ishte jo i knaqshëm (37,38%).

#### Cështja 1. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës. Cështje më rëndësi

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Me pas ne mënyrë të detajuar i paraqesim si më pas procedurat e krahasimeve dhe harmonizimeve.

##### Përshkrim i shkurtër për këtë sistem

DKA-ja për vitin 2018 ka realizuar të hyra vetëm për pagesa mujore për fëmijë në çerdhe, dhe për taksa administrative për fletëkërkesa.

Ishin 37 fëmijë që participojnë prindërit në çerdhen “Tulipanet”, për 32 fëmijë participimi ishte nga 30,00€, kurse 5 fëmijë participimi ishte 20,00€.

Pagesa mujore prej 30,00€, ishte sipas Rregullores në fuqi, kurse 20,00€, nuk është respektuar Rregullorja, pagesa mujore sipas Rregullores duhej të ishte 15,00€.

Qerdha e fëmijëve “Tulipanet” për periudhën audituese ka grumbulluar të hyra vetjake në vlerë prej 9.070,00€, tutje sipas raportit vjetor të mirëmbajtur nga zyrtari komunal i të hyrave vetjake janë realizuar të hyra vetjake në vlerë prej 9.070,00€, saldoja nga vitit 2017 ishte 599,06€, Totali i të hyrave ishte 9.669,06€. Kurse,

Për periudhën Janar – Mars të vitit 2019, ka inkasuar të hyra në shumën prej 2.210,00€, saldoja nga vitit 2018 ishte 629,06€, totali ishte në shumën prej 2.839,06€.

Për taksa administrative për Fletëkërkesa për periudhën audituese ishin grumbulluar të hyra vetjake në vlerë prej 287,00€, tutje sipas raportit vjetor të mirëmbajtur nga zyrtari komunal i të hyrave vetjake janë realizuar të hyra vetjake në vlerë prej 287,00€.

Totali i të hyrave ishte 9.356,00€.

Zyrtari përgjegjës në baza mujore ka harmonizuar dhe barazuar të hyrat vetanake me zyrtarin e të hyrave komunale në mënyrë të dokumentuara dhe në formë të shkruara.

#### **KONKLuzioni**

Mangësitë në menaxhimin e participimit dhe mungesa e rregulloreve/udhëzimeve për angazhimin evidencave në pagesa, e zvogëlojnë efikasitetin dhe e rrezikojnë arritjen e objektivave.

#### **4.1.3. Shpenzimet a janë kryer në mënyr të drejtë.**

Për të rishikuar se Menaxhmenti ka përgatitur një planifikim real për shpenzime dhe miratimin e pagesave konform rregullave ne kemi marrë për testim pagesat për ushqimin e fëmijëve për periudhën Janar - dhjetor të vitit 2018, shpenzimet ishin në shumën prej 9.462,31€, dhe për periudhën Janar – Mars të vitit 2019, shpenzimet ishin në shumën prej 2.063,40€.

Bazuar ne mostrat që i kemi marrë për testim dhe gjatë një vlerësimi dhe ekzaminimi të mostrave që i

kemi bërë kemi hasur dhe konstatuar disa gjetje të cilat do të i prezantojmë më pasë:

Çështja - 2. Shpenzimet dhe autorizimi i pagesave të mbivlerësuar

Të gjeturat

Nga dokumenti i egzaminuar dhe testet e kryera kemi konstatuar se shpenzimi i të hyrave vetanake është realizuar kryesisht për shpenzime për Çerdhen e fëmijeve.

Shpenzimet ishin kryer në bazë të 11 faturave në vlera të ndryshme, në shumën totale 9.462,31€, kurse për periudhën janar- mars të vitit 2019, ishin 2 fatura në shumën totale 2.063,40€.

Ishte shpërblyer ofertuesi (NTP. "MATRIX" në Rahovec) me kontratë me çmim dukshëm më të lartë:

Gjatë rishikimit të faturës nr. 01/2018 të datës 20.01.2018, Ishte shpërblyer ofertuesi me kontratë me çmim të disa artikujve dukshëm më të lartë se sa çmimi i tregut.

Gjatë rishikimit të faturës nr. 12/2018 të datës 10.12.2018, i njëjti ofertues ishte shpërblyer me kontratë me çmim të disa artikujve ma të ulët se sa në kontratën paraprake, edhe në këtë fatur si më lartë çmimi me TVSH ishin çmime të larta të disa artikuj ushqimor, se sa çmimi i tregut.

## KONLUZIONI

shpërblimi me kontratë i ofertueseve me çmim dukshëm më të lartë, dëmton buxhetin dhe rrit rrezikun e keqpërdorimit. Pagesat e faturave të kryera dhe mos korrigjimi me kohë i pagesave të mbivlerësuar ka ndikim në humbje buxhetore të buxhetit të DKA-së.

### 4.1.4. Raportet financiare për programin arsimor në Shkolla

Aktiviteti i ynë është bazuar në planifikimin e auditimit të brendshëm duke marrë parasysh edhe mjedisin ligjor brenda të cilit vepron dhe funksionon Entiteti i audituar dhe veshtërsit gjatë aktiviteteve me të cilat ballafaqohet i audituari.

Kontrollet e dizajnuara paraqesin një bazë të mirë për aplikimin e tyre në të gjitha shkollat.

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo Shkoll buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Kontrolla e brendëshme e menaxhmentit në Shkolla ka bërë një progres të lehtë Megjithatë, implementimi i këtyre proceseve mbetet ende për tu përmirësuar. Nuk vërehen ndryshime të mëdha tek planifikimet dhe kontrollet buxhetore, përmes testeve tona në fusha të ndryshme, të shpalosura më lartë që ndërlidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm,

Çështja 3. Implementimin i proceseve mbetet ende për tu përmirësuar

Të Gjeturat:

Përmes testeve tona në fusha të ndryshme, të shpalosura më lartë që ndërlidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm. Vërehen përmirime të menaxhimi i procesit dhe procedurave të buxhetit dhe shpenzimeve, megjithatë implementimi i këtyre proceseve mbetet ende për tu përmirësuar.

Nga testimet tona identifikuam dobësi në fushat në vijim si:

- Mangësi në kontrollin e shpenzimeve ditore nga komunalit, në dy Shkolla kishte shpenzime të larta në shpenzimin e ujit.  
Në SHMLP. "SELAJDIN MULLAABAZI" NË Rahovec, shpenzimet e ujit ishin 4.128,13€, kurse në " SHFMU. " Hamëz Thaqi" në Xërxe, shpenzimet e ujit ishin 1.908,42€
- Mangësi në përpilimin e raporteve periodike.
- Mangësi në raportimin financiar për programet e arsimit.
- Në realizimin e shpenzimeve kishte suficit apo deficit në shumicën e shkollave.

## KONKLUZIONI

Pagesat e faturave të kryera dhe mos korrigjimi me kohë i pagesave të mbivlerësuar ka ndikim në humbje buxhetore të buxhetit të Shkollës.

Duhet theksuar edhe më tutje se problemet për sa i përket prokurimit, dhe obligimeve janë çështje kyqe në të cilat DKA-ja duhet të fokusohet për të përmirësuar situatën.

### 4.1.5. Mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve në zyrën e personelit.

Çdo dosje të nëpunsit duhet ti ketë të dhënat përfshirë kopjen e dokumenteve që vërtetojnë moshën e nëpunsit civil, përgaditjen profesionale e arsimore, vendbanimin, një kopje e kontratës së punësimit dhe dokumentët tjera, kërkesën e punës dhe materialet plotësuese, detyrat e punës, pushimin dhe vijimin e punës, vlersimet, pagat, aftësimin, të dhënat e vijimit të kursëve të aftimit dhe të arriturat, Licencimi, Çertifikata e KKK. e tjera.

Çështja 4 - Mangësit në dosje të punëtorit

E Gjetura

DKA-ja nuk ka arritur të vendosur kontrolle adekuate sa i përket menaxhimit në mirëmbajtjen e dosjes së punëtorëve.

Gjatë ekzaminimit të dosjes së punëtorit është gjetur, në të shumtën e shkollave nuk ishin të kompletuara, gjëqë vërtetohet edhe nga regjistri i zyrtarit për mirëmbajtjen e dosjeve në zyrën e personelit.

## KONKLUZIONI

Janë vërejtur veprime të dukshme të kontrollit e cila është çështje e menaxhmentit për përmirësime të rëndësishme, që është kërkuar veprime të menjëhershme përmirësuese për tu mbrojtur në mënyrë adekuate kundrejt ekspozimit.

### 4.1.6. PARAJA E GATDHME (Petty – cash)

Regjistrimi i shpenzimeve nga nga petty-cash (paraja e imët) bëhet nga zyrtari i shpenzimeve i organizatës buxhetore, direkt pa zotim.

Gjatë rishikimit të parasë së imët në shkolla të gjeturat ishin si më poshtë:

- Në SHFMU. “Ardhmëria” në Rahovec, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “Hamëz Thaqi” në Xërxe, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “Katër Dëshmoret” në Ratkoc, pagesa është kryer pa fatur në vlerë prej 82,00€, është blerë material administrativ në shumën prej 40,00€ që ka kontrat dhe është në specifikacion.
- Në SHFMU. “Faik Konica” në Celin, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “Bajram Curri” në Krush të Madhe, nuk është bërë përshkrimi i shpenzimit në fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë. Mjetet financiare i kanë tërhequr dhe i kanë nënshkruar operatorët ekonomik.
- Në SHFMU. “Sopniqi” në Sopniq, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “Dëshmoret e Lirisë” në Pataqan i ulët, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë. Në shumën e shpenzimit prej 95,00€ nuk ka faturë.
- Në SHFMU. “Haki Stërmilli” në Zoqisht, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “Dëshmoret e Zatriqit” në Zatriq, në fletpranimin standard nuk kanë nënshkruar as

pranuesi i mjeteve as mbajtësi i mjeteve, me një pagesë në shumën prej 20,00€ nuk ka fletpranim standard, kurse pagesën tjetër prej 20,00€, nuk ka as fatur as fletpranim standard.

- Në SHFMU. “ Sakip Bellaqa” në Patataqan të epërm, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë.
- Në SHFMU. “ Nesimi Elshani” në Nagavc, në fletpranim standard nuk kishte përshkrim të shpenzimit, të pranuesi i mjeteve financiare është shenuar vetëm emri i firmës.  
Në SHFMU. “ Herojt e Kosovës” në Hoqë të vogël, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në as një pagesë, nuk kishte as një fatur, specuifikacioni i shpenzimit që është paraqitur në dosje është i shkolles “Nesimi Elshani” në Nagavc.
- Në SHFMU. “ Milaim Krasniqi” në Pastasel, nuk kishte fletpranim standard të tërheqjes së mjeteve, në një pagesë. Një pagesë në shumën prej 198,20€ është ndarë në dy pagesa të njëjtit operator.
- Në SHML. “ Ukshin Hoti” në Krush të Madhe, në fletpranim standard rubrika e pranuesit të mjeteve nuk figuron në fletpranim standard, ka nënshkruar vetëm mbajtësi i mjeteve, Me anë të dy faturave në shumën prej 9,99€ dhe 20,00€, kanë blerë derivate të naftës.

#### **KONKLuzioni**

Mos kompletimi në bazë të Rregullës financiare dhe Udhëzimi i Thesarit – 02 shpenzimi i parasë publike, neni 9.3, që vendos rregullat për përdorimin e parasë së imtë, mud të vije gjërë të keqpërdorimi.

#### **4.1.7. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut**

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja e obligojnë Entitetin të hartojnë regjistrin e rrezikut i dokumentuar dhe i kompletuar për një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja - 5 -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut çështje më prioritet të lartë.

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut , vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në forma të dokumentuar dhe të shkruar , mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

#### **KONKLuzioni**

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancë së suksesit të mësimave.

#### **REKOMANDIMET:**

##### **REKOMANDIMI – 1**

- Rekomandojm që të respektohet Rregullores komunale për tarifatat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale nr 576 date 28.02.2017.

##### **REKOMANDIMI - 2**

- Rekomandojm të sigurojë se janë vendos kontrolle funksionale që garantojnë një vlerësim korrekt të ofertave

në përputhje me kërkesat ligjore me qëllim të maksimizimit të vlerës për paranë e shpenzuar.

- Menaxhmenti të bëjë verifikimin e plotë të faturës , të autorizoj pagesa konform rregullores.

#### **REKOMANDIMI- 3**

- Rekomandojmë që të forcohet menaxhimi financiar, procedurat për planifikim të buxhetit dhe shpenzimve, Menaxhmenti të bëjë verifikimin e plotë të faturës ,të autorizoj pagesa konform ligjeve në fuqi.

#### **REKOMANDIMI – 4**

- Rekomandojmë që dosjet e puntorëve të Shkollave, në DKA, të paisen me dokumente të kompletuara burimore për të treguar gjendjen faktike të punëtorit.

#### **REKOMANDIMI – 5**

- *Rekomandojmë që paraja e imët në të gjitha shkollat të cekur më lartë mos të përdorën për shpenzime që mund të paguhet përmes procesit të shpenzimeve normale. dhe të kompletohet në bazë të Rregullës financiare dhe Udhëzimi i Thesarit – 02 shpenzimi i parasë publike, neni 9.3, që vendos rregullat për përdorimin e parasë së imtë.*

#### **REKOMANDIMI - 6**

- Rekomandojmë që DKA-ja në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për menaxhimin efektiv të rrezikut, dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performancën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmenti i lartë i komunës(në tekstin e mëtejme”llogaridhënia”).

### **PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):**

#### **2 . Objektivat e auditimit**

1. Pajtueshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi,
2. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave dhe shpenzimeve , ekziston dhe funksionon.
5. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanak
6. Mirëmbajtja e dosjes të punëtorëve në Shkolla.

#### **3. Fushëveprimi i auditimit do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:**

- Menaxhimi i lidhur me identifikimin, evidentimin dhe arkëtimin e te hyrave dhe autorizimi i shpenzimeve për periudhën kontabël 01.01. - 31.12.2018, dhe 01.01. - 30.03.2019.
- Lokacioni: Drejtoria Komonale e Arsimit
- Çerdha e Femijëve “Tulipanet” në Rahovec.
- Shkollat e Mesme dhe Filllore.

#### **1.3. EMËRTIMI I AUDITIMIT:**

**Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc në Drejtoritë: Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Administratës së Përgjithshme**

#### **TË GJETURAT:**



## **2.1. Realizimi i të hyrave vetanake në Drejtorin e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

1.1. Plani i inkasimit të të hyrave të taksave komunale për vitin 2018, si kategori dominuese e të hyrave, ka inkasuar në vlerë 25.507,14€ apo 23,40% të buxhetit të planifikuar (109.000,00€). shohim se fillimisht nuk ka pasur trend të rritjes ndaj planifikimit,

1.2. Kurse gjatë vitit 2017 ka inkasuar të hyra në vlerë 30.001,67€ apo 30,23% të buxhetit të planifikuar (99.232,00€). shohim se fillimisht nuk ka pasur trend të rritjes ndaj planifikimit, trend i mos rritjes ka ndikuar në inkasimin e borgjit, si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

Për periudhën Janar-Mars të vitit 2019, ka inkasuar të hyra në vlerë 6.393,97€ apo 6,21% të buxhetit të planifikuar 103.000,00(€). shohim se fillimisht nuk ka pasur trend të rritjes ndaj planifikimit, si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

Realizimi i të hyrave në vitin 2018 ishte më i ulët për 6,83%, ndaj realizimit të hyrave në vitin 2017. sepse ishte planifikimi më i lartë për 6,11%.

1.4. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për vitin 2018 ka qenë shumë e ulët 2.09%. Në vitin 2017 pjesëmarrja ka qenë 3,19%, në vitin 2018 ka pasur një rënje të letë të pjesëmarrjes e cila ka qenë 1,1%, për shkak të planifikimit më të lartë.

### **KONKLuzioni**

Realizimi i ulët i të hyrave krahasuar me planifikimin rrezikon ngecjen në realizimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake dhe mos përmbushjen e objektivave të Komunës.

### **REKOMANDIMI- 1**

- Rekomandojmë Drejtorin e audituar duhet të analizoj arsyet me trend të ultë në realizimin e të hyrave, gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm.

### **Çështja 1- Kushtëzimi i pagesës së tatimit mbi pronë**

Udhëzimi Administrativ 07/2011, për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në prone.

Qellimi i këtijë Udhëzimi Administrativ është që të definojë dhe përcaktojë shërbimet komunale të cilat Komuna mund ti kushtëzojë tatimpaguesit për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë.

### **E Gjetura:**

- Inkasimit i të hyrave të taksave për vitin 2018, ishte 23,40%, ndaj buxhetit të planifikuar, ishte shumë i ulët.
- Drejtoria e audituar e ka zbatuar kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë sipas Udhëzimit Administrativ 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, neni 7 që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj tatimpaguesve që nuk paguajnë detyrimet,
- Gjatë vitit 2018, kishte vetëm 29 kërkesa për leje ndërtimi, 28 ishin të aprovuara, kurse një ishte në shqyrtim.
- Për leje rrënimi kishte vetëm 4 kërkesa, 3 ishin të aprovuara, kurse një ishte hudhura.
- Për leje përdorimi ishte vetëm 1 kërkesë në shqyrtim.
- Për kushte ndërtimore kishte 79 kërkesa, 51 ishin të aprovuara, 17 të reja, 7 në shqyrtim dy të hudhura.
- Për pelqim kishte 68 kërkesa, 45 ishin të aprovuara, 18 të reja, 2 në shqyrtim 3 të hudhura.
- Gjatë periudhës (janar-mars) të vitit 2019, kishte vetëm 7 kërkesa për leje ndërtimi, 6 ishin të

aprovuara, kurse një ishte në shqyrtim, duke u bazuar nga ndërtimet në teren në tërë teritorin e Komunës së Rahovecit konstatohet së ishin shumë pakë kërkesa.

- Për kushte ndërtimore kishte 21 kërkesa, 7 ishin të aprovuara, 1 e re, 13 në shqyrtim.
- Për pelqim kishte 20 kërkesa, 16 ishin të aprovuara, 4 në shqyrtim.

Ne kemi testuar të gjitha mostrat dhe kemi identifikuar se ka pasur shumë pak kërkesa për leje ndërtimi. Kjo tregon në mos azhuritetin e Inspektionit, që vërtetohet se është bërë pak në kalkulim të vlerës financiare të sipërfaqes së objekteve për të cilin është dhënë leja e ndërtimit.

#### **KONKLuzioni**

Inkasimet jo të kënaqshme të të hyrave, faturimi më i ulët dhe vonesat në vendimet për dhënien e lejeve ndërtimore reduktojnë të hyrat dhe si pasojë rrezikojnë arritjen e objektivave të Komunës.

### **2.2. Realizimi i të hyrave vetanake në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme**

Plani i inkasimit të të hyrave për vitin 2018, si kategori mesatare e të hyrave, ka inkasuar të hyra në vlerë 101.629,00€ apo 101,63% të buxhetit të planifikuar (100.000,00€). shohim se fillimisht ka pasur trend të mbi rritjes ndaj planifikimit, për 8,33%,

- Gjatë vitit 2017 ka inkasuar të hyra në vlerë 91.974,00€ apo 91,97% të buxhetit të planifikuar (100.000,00€). shohim se fillimisht ka pasur trend të rritjes ndaj planifikimit.

Gjatë periudhës Janar-Mars të vitit 2019 ka inkasuar të hyra në vlerë 15.036,00€ apo 17,79% të buxhetit të planifikuar (84.500,00€).

Realizimi i të hyrave në vitin 2018 ishte më i lartë për 9,66%, ndaj realizimit të hyrave në vitin 2017, shohim se ka pasur trend të rritjes në vitin 2018, si rezultat i angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

1.4. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për vitin 2018 ka qenë mesatarisht 8,33%. Në vitin 2017 pjesëmarrja ka qenë 7,54%, në vitin 2018, shohim se ka pasur një rritje të letë të pjesëmarrjes e cila ka qenë 0,79%,

shohim se ka pasur trend të rëmbjes për 11,01%, ndaj inkasimit të të hyrave në periudhës Janar-Mars të vitit 2018, kurse ndaj vitit 2017, realizimi i të hyrave ishte më i lartë për 5,82%,

#### **Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të të hyrave**

##### **E gjetura:**

Drejtorja e audituar nuk kishte bërë analiza dhe vlerësime të sakta në procesin e planifikimit të të hyrave. Niveli i lartë i realizimit të të hyrave shkakton në mbirritje ndaj planifikimit.

#### **KONKLuzioni**

Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja e planifikimit nuk është bazuar në analiza dhe vlerësime reale nga Drejtorja e audituar. Mos caktimi i planifikuar në bazë të ngarkesës nëpër kategori mund të ndikojë në mos arritjen e objektivave.

#### **Çështja 1- Kushtëzimi i pagesës së tatimit mbi pronë**

Udhëzimi Administrativ 07/2011, për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës të tatimit në pronë.

Qellimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të definojë dhe përcaktojë shërbimet komunale të cilat Komuna mund ti kushtëzojë tatimpaguesit për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë.

**E Gjetura:**

- Inkasimi i të hyrave të taksave në shërbimin civil për vitin 2018, ishte 101,63%, ndaj buxhetit të planifikuar.
- Drejtoria e audituar pjesërisht e ka zbatuar kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë sipas Udhëzimit Administrativ 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, neni 7 që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj tatimpaguesve që nuk paguajnë detyrimet,
- Gjatë vitit 2018 ishin dhënë 56.000 çertifikata, në muajin janar – mars të vitit 2019 ishin dhënë 11.752 çertifikata.
- Është marrë mostra për rishikim nga të gjitha kërkesat, në zyrët e gjendjes civile në Qendër dhe në Fshatra.
- Në zyrën e gjendjes civile në Qendër gjatë rishikimit të mostrës për periudhën Janar- Marsë është konstatuar se në 32 kërkesa, zyrtari për lëshimin e kërkesave nuk e ka kërkuar vërtetimi i tatimit në pronë, vërtetohet se në 32 kërkesa mungojn vërtetimi i tatimit në pronë.
- Në zyrën e gjendjes civile në Xërxe gjatë rishikimit të mostrës për periudhën Janar- Marsë është konstatuar që 90%, të kërkesave nuk e kanë kërkuar vërtetimin e tatimit në pronë, vërtetohet se në kërkesa mungojn vërtetimet e tatimit në pronë.
- Në zyrën e gjendjes civile në Krushe të Madhe gjatë rishikimit të mostrës për periudhën Janar- Marsë është konstatuar që 80%, të kërkesave nuk e kanë kërkuar vërtetimin e tatimit në pronë, vërtetohet se në kërkesa mungojn vërtetimet e tatimit në pronë.
- Në zyrën e gjendjes civile në Opterush, Drenoc, Çifllak dhe në Ratkoc, gjatë rishikimit të mostrës për periudhën Janar- Marsë është konstatuar që 99%, të kërkesave e kanë kërkuar vërtetimin e tatimit në pronë, vërtetohet se në kërkesa ishin të vendosura vërtetimet e tatimit në pronë.

**KONKLUZIONI**

Mos kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve me pagesën e borxheve aktuale e ulë mundësinë e inkasimit të borxheve.

**REKOMANDIMET:****REKOMANDIMI- 1**

- Rekomandojm Drejtorin e audituar duhet të analizoj arsyet me trend të ultë në realizimin e të hyrave, gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm.

**REKOMANDIMI- 2**

- Drejtoria e audituar duhet të sigurojë një plan konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave.

**REKOMANDIMI - 3**

- Rekomandojm drejtorin e audituar duhet të sigurojë që plani i të hyrave është i bazuar në analiza dhe vlerësime të sakta nga njësit përkatëse që i grumbullojnë ato, për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre.

**REKOMANDIMI- 4**

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar të rsepektoj urdhresën e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në prone dhe të tjera, siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ

**PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):**

**Fushëveprimi:**

Në bazë të Kërkesës të datës 19.03.2019, lëshuar nga Kryetari i Komunës që të bëhet auditimi ad-hoc për të hyrat vetanake në Drejtorit të cekur më lartë, për periudhën janar – Dhjetor vitit 2018, dhe për periudhën e parë të vitit 2019.

**Objekti i Auditimit:**

**2.3. Realizimi i të hyrave vetanake**

**1.4. EMËRTIMI I AUDITIMIT:**

**Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

**TË GJETURAT:**

**2. REZULTATET:**

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit, ne identifikuam si më poshtë:

**2.1. Realizimi i të hyrave vetanake**

Të hyrat njihen kur kryhen shërbimet për punët e përfunduara sipas Rregullorës së paraparë, konkretisht për shërbime komunale për Qytetaret, gjatë vitit 2018 dhe vitit 2019.

Gjatë vitit 2018, Drejtorit në fjalë kanë gjeneruar të hyra në vlerë prej 797.193,56€.

**2.2. Planifikimi i të hyrave vetanake**

Komuna planifikon të hyrat vetanake në mënyrë që të vlerësojnë sasinë e të hyrave vetanake që do të kenë në dispozicion që të i përdorin për të financuar shpenzimet e nevojshme. Për planifikimin objektiv të të hyrave, komuna ka nevojë për sa më shumë informata faktike rreth bazës tatimore dhe efektit të ndryshimeve legjislative. Fakti se llojet e tarifave, ngarkesave dhe gjobave, të caktuara në procesin buxhetor komunal janë të përcaktuara qartë në legjislacion, kërkon nga komunat të monitorojnë këto të hyra, të analizojnë faktorët ekonomik që ndikojnë në vëllimin e të hyrave dhe të shqyrtojnë të gjitha mundësitë për rritjen e tyre të vazhdueshme.

**2.3. Arkëtimi i të Hyrave Vetanake**

Është e rëndësishme që të hyrat e grumbulluara nga komunat të rikthehen tek qytetarët në formën më të mirë të mundshme të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe më cilësore, pra të ju dëshmohet qytetarëve se menaxhimi i mjeteve të tyre financiare është transparent dhe që përdoret për shërbime afër tyre.

Komuna i mbledh të hyrat vetanake në dy forma: si të hyra të mbledhura drejtperdrejt nga komuna si aktivitet i komunës dhe si të hyrat e arkëtuara nga niveli qendror (në tekstin e mëtejme, të hyrat indirekte) të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake. Arkëtimi në periudhën 2018 ka shënuar rritje në krahasim me vitet paraprake. Nëse shikohen trendet e arkëtimit për periudhën 2018 vërehet një rritje e dukshme.

Të hyrat vetanake direkte Bazuar në nenin 8 të Ligjit për Financa të Pushtetit Lokal, komunat e

Republikës së Kosovës mund të inkasojnë të hyra venatake për shërbimet e ofruara sipas kategorive të të hyrave vetanake të përcaktuara në këtë Ligj. Me qëllim të një pasqyre të përgjithshme të të hyrave direkte, në vijim janë rradhitur të hyrat e arkëtuara sipas stukturës dhe trendit të arkëtimit sipas viteve.

#### **2.4. Bartja e të hyrave**

Një nga dukuritë që është e shprehur nga viti në vit është edhe mosshfrytëzimi i të hyrave vetanake në vitin kur arkëtohen, pasi që pastaj bëhet bartja e tyre në vitin vijues. Duke përjashtuar momentet kur këto të hyra arrijnë në muajin e fundit të vitit (që megjithatë janë raste të kufizuara), mosshfrytëzimi i të hyrave vetanake kur të mirret parasysh nevoja e madhe për investim në komunë është brengosëse. Për shembull në Janar të vitit 2018 totali i bartjes së të hyrave vetanake të pashfrytëzuara.

#### **2.5. Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake.**

Në bazë të Rregullorës për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 576 të dates 28.02.2017, është caktuar tarifa nga taksat për shëndrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, dhënjën me qira të tokës bujqësore dhe dhëia e pëlqimeve, vlerësimeve dhe vërtetime.

Drejtoria e audituar ka realizuar të hyra vetëm nga ndrim destinimi i tokës, qiraja e tokës bujqësore, taksat administrative për fletëkërkesa dhe nga participimi nga bujqësia.

- Plani i inkasimit të hyrave për vitin 2018, si kategori më e ultë e të hyrave, ka inkasuar në vlerë 30.774,45€ apo 236,73% të buxhetit të planifikuar (13.000,00€). shohim se fillimisht ka pasur trend të rritjes ndaj planifikimit, trendi i rritjes ka ndikuar në mos vlerësimin e shumës të hyrave në participim të bujqësisë e cila e ka rritur inkasimin për 86,96% .
- Gjatë vitit 2017 ka inkasuar të hyra në vlerë 725,00€ apo 4,14% të buxhetit të planifikuar (17.500,00€). shohim se fillimisht ka pasur trend të zbritjes ndaj planifikimit, trendi i zbritjes ka ndikuar në inkasimin e dobët të hyrave, si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.
- Gjatë periudhës Janar-Mars të vitit 2019 ka inkasuar të hyra në vlerë 32.537,88€ apo 306,96% të buxhetit të planifikuar (10.600,00€). shohim se fillimisht ka pasur trend shumë të lartë ndaj planifikimit, edhe në periudhën e parë të vitit 2019, trendi i rritjes ka ndikuar në mos vlerësimin në shumën të hyrave në participim të bujqësisë e cila e ka rritur inkasimin për 198,50% .

Realizimi i të hyrave në vitin 2018 dhe në periudhën e parë të vitit 2019, ishte shumë i lartë, trendi i rritjes ka ndikuar në inkasimin e participimit të bujqësisë, kurse në vitin 2017 nuk kishte të inkasuara nga participimi i bujqësisë.

Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për vitin 2018 ka qenë mesatarisht 2,52%. Në vitin 2017 pjesëmarrja ka qenë 0,08%,

Në vitin 2018 ka pasur një ngritje të letë të pjesëmarrjes krahasuar me vitin 2017, e cila ka qenë 2,44%.

#### **Çështja 1 – Planifikimi i dobët i të hyrave**

Të Gjeturat:

Progresi ndaj planit për 236,73%, kurse për periudhën e parë ishte 306,96€, menaxhmenti nuk ka dizajnuar dhe implementuar procedura në vlerësimin e shumës të të hyrave.

Aktiviteti i kontrollit të brendshëm nuk ka bërë vlerësim dhe krahasim vjetor të të hyrave të realizuara për të caktuar planifikimin të paraqitur në raport, për të parandaluar dhe identifikuar diferencat në raportim.

Në bazë të Rregullorës të hyrat ishin shumë të ulëta, duke përjashtuar participimin nga bujqësia që nuk përfshihet si e hyrë në Rregullore.

Planifikimi i të hyrave nga viti 2017, në vitin 2018, është zbritur për 25,71€, kurse në vitin 2019, është zbritur për 39,43€.

## KONKLUZIONI

Proceset e dobëta të kontrolleve gjatë caktimit të hyrave të planifikuara , planifikimi jo adekuat mund të rezultojë me dobësi në kontrollin dhe monitorimin e performancës së hyrave.

### 2.6. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës. Çështje më rëndësi.

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Me pas në mënyrë të detajuar i paraqesim si më pas procedurat e krahasimeve dhe harmonizimeve .

Sipas raportit financiar të zyrtarit kryesor, të hyrat në vitin 2018 ishin në shumën prej 30.774,45€, kurse Drejtoria e audituar nuk kishte regjistër në form raportit për të hyrat në vitin 2018, as në periudhën e parë (janar-mars) të vitit 2019.

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar në vitin 2018, që ka realizuar të hyra, dhe Sipas raportit financiar të zyrtarit të hyrave vetanake të komunës, nuk është bërë krahasimi dhe harmonizimi i të hyrave në mes të dy entiteteve, për të vërtetuar që të hyrat janë të sakta dhe të destinuara në kode përkatëse. Në periudhën janar- mars të vitit 2019 të hyrat ishin të barazuara në mes të dy entiteteve, por nuk kishte regjistër në form raportit për të hyrat.

### 2.7. Taksa për shëndrimin e tokës bujqësore në tokën ndërtimore

Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha 01 Nr. 576 të datës 28.02.2017.

Në jemi fokusuar në të hyrat të taksat për shëndrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore që realizonë Drejtoria dhe kemi përzgjedhur për testim e tërë popullacionin.

**Çështja 2 – Inkasimi i dobët, dhe mosmbajtja e të dhënave për të hyra të sakta.**

#### TË GJETURAT:

Gjetjet tona të auditimit në këtë drejtim tregojnë se të hyrat janë inkasuar me anë të faturës në llogarin bankare.

Sipas të dhënave për të hyrat të Drejtorisë për Buqësi, Pylltari dhe zhvillim rural, në vitin 2018, ishin vetëm katër (4) fatura të inkasuara në një shumë prej 1.263,00€, sipas raportit të zyrtarit të të hyrave pranë Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, të hyrat ishin në shumën prej 1.263,00€, edhe në periudhën janar – mars të vitit 2019, ishin vetëm dy fatura të inkasuara në një shumë prej 10,058,00€, nuk kishte diferenca në të hyra, ishin të barazuara, por nuk na është ofruar ndonjë regjistër në form raportit për krahasimin dhe harmonizimin e të hyrave.

Inkasimi i të hyrave ishte shumë i ulët.

- Konstatohet se bashkpunimi nuk ka qenë i duhur në mes të Drejtorisë për Inspeksion dhe Drejtorisë për Buqësi, Pylltari dhe zhvillim rurale, ka ndikuar në inkasimin shumë të ulët, si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

## KONKLUZIONI

Mos mbajtja e duhur e shënimeve në krahasimin dhe harmonizimin e të hyrave në regjistra të njësive vartëse të Drejtorisë, krijon mundësinë që këto të hyra të mos raportohen drejtë. *Mungesa e evidencave të qarta dhe të mjaftueshme për të hyrat, është si rezultat, raportime jo të sakta dhe të besueshme.*

### 3.8. Subvencionet

Subvencionet ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural që kanë për qëllim zgjerimin dhe

përmirësimin e prodhimtarisë së tyre. Pagesa e subvencioneve bëhet në formë të pagesave direkte (në Thesar) dhe në formë të granteve nga zyra e financave. Politikat dhe buxheti përgatiten nga Autoriteti Menaxhues.

Nuk ka të gjetura në këtë drejtim.

## **2.8. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut**

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja e obligojnë Entitetin të hartojnë regjistrin e rrezikut i dokumentuar dhe i kompletuar për një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

### **Çështja - 3 -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut.**

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut , vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në forma të dokumentuar dhe të shkruar , mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

### **KONKLUZIONI**

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancës.

## **REKOMANDIMET:**

### **REKOMANDIMI – 1**

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të siguroj menaxhim të mirë të të hyrave, bazë të qartë në krahasimin dhe vlerësimin e shumës së të hyrave të realizuara dhe me rastin e planifikimit të merren parasysh të gjitha aspektet duke përfshirë llojet adekuate të të hyrave.

### **REKOMANDIMI – 2**

- Rekomandojmë Drejtorin e audituar në forcimin e kontroleve të brendshme si dhe monitorimin e zyrës vartëse të Drejtorisë që krijojnë të hyra, të mbajnë evidenca të plota dhe të sakta në mënyrë që të hyrat të jenë të krahasuara dhe të harmonizuara, me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës.

### **REKOMANDIMI - 3**

- Rekomandojmë që të thellohet bashkëpunimi në mes të Drejtorisë për Buqësi, Pylltari dhe zhvillim rural dhe Drejtorisë për punë Inspektuese, për rritjen e inkasimin në të hyra.

### **REKOMANDIMI - 4**

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për menaxhimin efektiv të rrezikut, dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll

**PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):**

**2. Fushëveprimi dhe objektivat e këtij auditimi janë:**

**2.1. Fushëveprimi:**

Fushëveprimi i auditimit është viti 2018, dhe periudha Janar-Mars të vitit 2019, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Identifikimin e të hyrave, shpenzimeve, aktvendimet, regjistrimet, evidentimet, pagesat dhe barazimet.

**2.2. Objektivat e këtij Auditimi janë:**

- Realizimi, barazimi dhe harmonizimi i të hyrave.
- Taksa për shëndrimin e tokës bujqësore në tokën ndërtimore.
- Tarifatat minimale (fellestare) për dhënie me qira të tokës bujqësore
- Dhënia e pelqimeve, vërtetimet nga lëmi i bujqësisë.
- Dhënia e Subvencioneve.

**1.5. EMËRTIMI I AUDITIMIT:**

**Auditimi i brenshëm në zyrën e Personelit**

**TË GJETURAT:**

**3. REZULLTATET**

**3.1. Mirëmbajtja e dosjeve të personelit**

Administrata komunale kishte 160 pozita, prej të cilave 12 pozita janë të lira – vakante, ndërsa aktualisht janë 148 punëtor.

Çdo dosje të nëpunësit duhet të ketë të dhënat përfshirë kopjen e dokumenteve që vërtetojnë moshën e nëpunësit civil, përgaditjen profesionale e arsimore, vendbanimin një kopje e kontratës së punësimit dhe dokumentet tjera, kërkesën e punës dhe materialet plotësuese, detyrat e punës, pushimin dhe vijimin e punës, vlersimet, pagat, aftësimin dhe hollësit e çfarëdo mase disiplinore, të dhënat e vijimit të kursëve të aftësimit dhe të arriturat.

Gjatë ekzaminimit të dosjeve duke marrë mostrën nga popullacioni, nuk kemi hasur në të gjetura.

Nuk ka të gjetura në këtë drejtim.

**3.2. Sigurimi i mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatitja e konkurseve, akt emërimit, kontratat për marrëveshjet e punës, procedimi.**

Çështja C2 – Menaxhim adekuat i të angazhuarve përmes kontratave të përkohshme

- Gjatë rishikimit të konkurseve nr. 2363/2018, 2236/2018, 2362/2018 vitit 2018 kishte të 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës të angazhuar. Prej tyre 7 (shtatë) janë angazhuar me kontrata pune me kohë të caktuar bazuar në Ligjin e Punës dhe 10 (dhjetë) prej tyre ishin me marrëveshje për shërbime të veçanta bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil. Ne kemi vërejtur edhe largimet nga puna



prej tyre ishin 8 (tetë) punonjës, 5 (pesë) prej tyre ishin dalur në pension, një kishte ndruar jetë, një kishte dhënë dorëheqje, kurse një ishte larguar nga puna. Gjatë ekzaminimit të konkurseve nr. 55/2019, 56/2019, 57/2019, 43/2019, dhe 44/2019, në periudhën janar – maj të vitit 2019, kishte të angazhuar 37 (tridhjetë shtatë) punonjës të angazhuar. Prej tyre 2 (dy) janë angazhuar me kontrata pune me kohë të caktuar bazuar në Ligjin e Punës dhe 9 (nëntë) prej tyre ishin me marrëveshje për shërbime të veçanta bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil. Ne kemi vërejtur edhe konkurse nr. 55/2019, 56/2019, 57/2019, marrëveshje për shërbime të veçanta prej tyre ishin 25 (njëzetëpesë) punonjës, gjërë sa Komuna lidhë kontratë me operatorin fitues, .

- Rregulla financiare 01/2013 në nenin 33 specifikon që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhën përmes listës së pagave. Ligji për Shërbimin Civil nr.03/L-149 në nenin 12 përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta.

Nuk ka të gjetura në këtë drejtim.

### 3.3. Zbatimin i legjislacionit dhe procedurat për punësimin.

– Mangësitë e marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Të Gjeturat

- Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2019 kishte të angazhuar 25 punonjës me (MSHV), gjërë sa Komuna lidhë kontratë me operatorin fitues.
- 25 punonjës me (MSHV), në vitin paraprak ishin të angazhuar të operatori ekonomik që ishte kontrata e lidhur gjer me datën 18.12.2018
- Ka një konfuzion të këto kontrata pasi që për të njëjtën pozitë angazhimi bëhet herë me ligjin e shërbimit civil e herë me ligj të punës. Po ashtu, vërehet se stafi ishte i angazhuar kryesisht për pozita të rregullta të punës. Arsyeja pse janë lidhur këto kontrata ishte mungesa e lidhës së kontratës me operatorin fitues, me anë të procedurës së prokurimit.
- Kontratat ishin të lidhura më datën 17.01.2019,
- kontratat Sipas zyrtarëve komunal, mangësitë e identifikuara, janë pasojë e mungesës së buxhetit për staf të ri për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës, krahasuar me kërkesat.

### KONKLuzioni

Mbulimi i pozitave me kontrata të përkohshme rritë rrezikun për rritje të pa planifikuar të shpenzimeve dhe mund të ndikojnë në mos realizimin e objektivave tjera të përcaktuara.

### REKOMANDIMI - 1

- Rekomandojmë që marrëveshjet për shërbime të veçanta janë për punë specifike dhe për to zhvillohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor.

### REKOMANDIMET:

## REKOMANDIMI - I

- Rekomandojmë që marrëveshjet për shërbime të veçanta janë për punë specifike dhe për to zhvillohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor.

## PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

### 4. Fushëveprimi dhe objektivat e këtij auditimi janë:

#### 4.1. Fushëveprimi:

Fushëveprimi i auditimit është viti 2018, dhe periudha Janar-Maj të vitit 2019, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Identifikimin e dosjes, procedurat për punësim, kontratat, konkurse, procedimi i pagave.

#### 4.2. Objektivat e këtij Auditimi janë:

1. Mirëmbajtja e dosjeve të personelit;
2. Sigurimi i mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatitja e konkurseve, akt emërimet, kontratat për marrëveshjet e punës, procedimi i pagave.
3. Zbatimin e legjislacionit dhe procedurat për punësimin

## 1.6. EMËRTIMI I AUDITIMIT:

**Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike, Komunale.**

## TË GJETURAT:

### 4. REZULLTATET

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e prezantimit dhe shpalosjen e taksave për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, vendosjen e objekteve të përkohshme dhe në kryerjen e testimeve substanciale për të konfirmuar saktësinë dhe validitetin e taksave për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike.

#### 4.1. REALIZIMI I TË HYRAVE

Drejtoria e Shërbimeve Publike Komunale ka vendosur disa kontrole mbi të hyrat, megjithatë, ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme sidomos në planifikimin, në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuat në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga shfrytëzimi i pronës publike, vendosja e objekteve të përkohshme dhe borxhet tjera.

Drejtoria e audituar planifikon të hyrat vetanake në mënyrë që të vlerësojnë sasinë e të hyrave vetanake që do të kenë në dispozicion që të i përdorin për të financuar shpenzimet e nevojshme.

Për planifikimin objektiv të të hyrave, Drejtoria e audituar, ka nevojë për sa më shumë informata faktike rreth bazës së tarifave dhe efektit të ndryshimeve legjislative.

Fakti se llojet e tarifave dhe ngarkesave, të caktuara në procesin buxhetor komunal janë të përcaktuara

qartë në legjislacion, kërkohet nga Drejtoria e audituar të monitorojnë këto të hyra, të analizojnë faktorët ekonomik që ndikojnë në vëllimin e të hyrave dhe të shqyrtojnë të gjitha mundësitë për rritjen e tyre të vazhdueshme.

Në bazë të Rregullorës nr. 576 të datës 28.02.2017, ka realizuar të hyra nga Taksat për Gërmim, taksat tjera administrative, taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, qiraja nga objektet e përkohshme, dhënja e lejes për autotaxi dhe linja për autobusa.

Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave vetjake, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Për vitin 2018 ishin planifikuar të hyra në shumën prej 425.000,00€, derisa shuma e inkasuar ishte në shumën prej 20.170,41€, progresi ndaj planit ishte 4,75%. Kurse,

Për periudhën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2019, ishin planifikuar në shumën prej 160.800,00€, derisa shuma e inkasuar ishte në shumën prej 7.762,74€, progresi ndaj planit ishte 4,83%.

#### Çështja 1 – Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave

##### Të Gjeturat:

- ✓ Inkasimi i të harave në periudhën janar – qershor të vitit 2019, ishte në shumën prej 7.762,74, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2018 ishin në shumën prej 9.506,63€, Nëse e shikojm trendin e arkëtimit, vërehet një rënje e dukshme në krahasim me periudhën e njëjtë të vitet paraprak për (18,34%).

Në raportin financiar ishin përfshir të hyrat nga:

- ✓ Taksat për demolim (Gërmim) të planifikuar ishin në shumën prej 1.800,00€, të inkasuara ishin vetëm 17,28€ (0,96%).
- ✓ Shfrytëzimi i pronës publike të planifikuara ishin në shumën prej 10.000,00€, të inkasuara ishin vetëm 3.216,22€ (32,16%).
- ✓ Qëraja nga objektet publike të planifikuara ishin në shumën prej 8.000,00€, të inkasuara ishin vetëm 2.449,24€ (30,62%).
- ✓ Taksat për mbeturina të planifikuar ishin në shumën prej 140.000,00€, nuk kishte të inkasuar (0,0%). Në vitin 2018, të planifikuara, ishin emruar në raportin financiar (licenca për aktivitete individuale) ishin në shumën prej 400.000,00€, kurse në vitin 2019, ishin në shumën prej 140.000,00€, konstatohet se ky planifikim për mbeturina, nuk është planifikuar mirë, definuar dhe destinuar drejt, në të cilën ka ndikuar në xerro inkasim. Nuk ekziston një planifikim i analizuar për të hyrat e përgjithshme dhe këtë e vërteton diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit. Gjithashtu, mungon arsyeshmëria e një planifikimi të tillë kur dihet se edhe realizimi në vitin e kaluar ka qenë xerro inkasim.
- ✓ Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për vitin 2018 ka qenë mesatarisht 1,65%.

#### KONKLuzioni

Performanca jo e mirë e realizimit të të hyrave sipas planit vjetor ndikon negativisht në aspektin buxhetor të komunës e po ashtu edhe në mos realizimin e objektivave të Drejtorisë. Planifikimi jo i realizuar rrit rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimin e parasë së gatshme.

Planifikimi i të hyrave që nuk bazohet në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ndikon në shfaqjen e differenceve në mes planifikimit dhe realizimit, me efekt edhe në procesin përfundimtar të shpenzimeve.

#### Çështja 2 - Mos barazimi dhe harmonizimi i të hyrave

## Gjetja

- ✓ Sipas raportit të zyrtarit të hyrave komunale të hyrat ishin në shumën prej 7.762,74€, kurse, sipas raportit të zyrtarit të entitetit të audituar të hyrat ishin në shumën prej 7.715,60€, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 47,14€.
- ✓ Drejtoria e audituar nuk ka arritur të bën barazim e të dhënave duke përfshirë saldoto mujore për të hyrat, nuk janë harmonizuar në mënyrë sistematike (çdo muaj) gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2019 me zyrtarin kryesor për të hyra siç kërkohet me rregullën Nr. 03/2010 neni 13.3. Kjo situatë është për shkak të neglizhencës të zyrtarit komunal të drejtorisë përkatëse.
- ✓ Zyrtari i të hyrave pranë drejtorisë të audituar, ka kërkuar të bëjë krahasimin dhe harmonizimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave komunale.
- ✓ Me anë të komentit thuhet se diferenca e të hyrave qëndron, sepse pagesa me anë të dëftesës është bërë në muajin korrik, mirpo nuk na është ofruar dëshmi në formën e dokumentuar.

## KONKLuzioni

Mos harmonizimet e të hyrave, ndikojnë në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimeve të mundshme në kode të gabuara të transaksioneve.

### 4.2. Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsirës publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara. (Shfrytëzimi i pronës publike me kod 50405)

- ✓ Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga zyra e shërbimeve publike, Drejtoria e audituar për vitin 2018, kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 12.000,00€, ndërsa kishte inkasuar 13.626,41€, progresi ishte 113,55%.
- ✓ Në periudhën e gjashtëmujorshit të vitit 2019, të planifikuara ishin në shumën prej 10.000,00€ të inkasuara ishin në shumën prej 3.216,22€ progresi ishte 32,16%.
- ✓ Ishin 59 subjekte afariste që kan parashtrur kërkesë për shfrytëzimin e hapsirës publike, Drejtoria e audituar sipas kërkesave është dalë në teren, është bërë verifikimi i hapsirës publike, janë bërë procesëverbale për të lidhur kontratë.

### Çështja 3 - Mos respektimi i kontratës së përkoheshme

#### Të Gjeturat

- ✓ Për periudhën e gjashtëmujorshit të vitit 2019 ishin 59 kërkesa për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike.
- ✓ Drejtoria e audituar sipas kërkesave është dalë në teren, është bërë verifikimi i hapësirës publike, janë bërë procesëverbale për të lidhur kontratë, gjëre me tani ende nuk është bërë lidhja e kontratës me shumë subjekte afariste.
- ✓ Në vitin 2018, disa kontraktues të përkohshëm të hapësirës publike nuk e kanë respektuar kontratën kanë shpërtëzuar hapsira publike që nuk janë përfshirë në kontratë.
- ✓ Drejtoria përkatëse me dalje në teren kishte dhënë vërejtje për sipërfaqe që nuk ishin të përfshirë në kontratë, mos respektimi i vërejtjes nga ana e shfrytëzuesve, kanë ngritur aktvendim për marrjen e masave për mos respektim të kontratës së përkoheshme.
- ✓ Drejtoria për punë inspektuese në bazë të aktvendimeve të Drejtorisë së audituar, ka qenë gjëre diku azhure në marrjen e masave në teren.

## KONKLuzioni

Dhënia në shfrytëzim të hapësirës publike me kontratë, eliminon mundësinë e pjesëmarrjes, në sipërfaqe publike pa kontratë. Dobësitë e identifikuara në mos menaxhimin e kontratave për shfrytëzimin e hapësirës publike rezultojnë në uzurpimin e sipërfaqës publike dhe reduktojnë aftësinë e Drejtorisë për inkasimin e të hyrave nga burimet vetjake.

#### **4.3, Taksat për vendosjen e Objekteve të Përkohshme ( qiraja nga objektet publike me kod 50408)**

- ✓ Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga zyra e shërbimeve publike, të hyrat e planifikuara në vitin 2018 ishin në shumën prej 10.000,00€, të inkasuara ishin 1.530,60€ progresi ndaj planit ishte shumë i ulët 15,31%.
- ✓ Në periudhën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2019, të hyrat e planifikuara ishin në shumën prej 8.000,00€, të inkasuara ishin 2.449,24€, progresi ndaj planit ishte 30,62%.
- ✓ Ishin 31 subjekte afariste që kanë vendosur objekte të përkohshme në pronat shtetërore, Drejtoria e audituar sipas kërkesave është dalë në teren, është bërë verifikimi I objekteve të përkohshme, janë bërë procesëverbale për të lidhur kontratë.

#### **Çështja 4 - Mos inkasimi i duhur i te hyrave nga taksa e veprimtarisë**

##### **Të Gjeturat**

- ✓ Të inkasuar në vitin 2018 ishin në vlerë 1.530,60€, progresi ndaj planit ishte i ulët 15,31%, sepse taksat nga vendosja e objekteve të përkohshme nuk është bërë e hyrë në kodin e caktuar, dhe ishin të inkasuar gabimisht në SIMFK.
- ✓ Sipas kontratave të nënshkruara nga ana e Drejtorisë të audituar për dhënien në shfrytëzim të pronës për vendosjen e objekteve të përkohshme **Taksat** duhet të paguhet brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
- ✓ Borgjet nga vitet paraprake ishin inkasuar, përveq katër(4) shfrytëzues që nuk ju kanë përgjigj obligimit,
- ✓ Shfrytëzuesi në nr. 5 të regjistrit për objekte të përkohshme që nga vitit 2017 nuk ka lidhur kontratë as që ka kryer obligim, vazhdon ta shfrytëzojë lokalitetin ilegalisht.
- ✓ Drejtoria për punë inspektuese nuk ka marrë masa për të detyruar shfrytëzuesin për të lidhur kontratë ose mbylljen e objektit.
- ✓ Në shumë raste kishte vonesa në shlyerjen e obligimeve, në katër (4) raste prej tyre drejtoria e audituar nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për arkëtimin e këtyre të hyrave. Shuma e borxhit ishte 2.827,80€. Kurse, borgji total ishte në shumën prej 7.391,20€.
- ✓ Faturimi i rregullt ishte bërë nga ana e Drejtorisë, mos aplikimi i masave efektive nga ana e Drejtorisë për punë inspektuese në lidhje të kontratës për arkëtimin e të hyrave, ka ndikuar në vonesa në arkëtimin e të hyrave nga ana e shfrytëzuesve të objekteve të përkohshme dhe ka pasuar papërgjegjësi të shfrytëzuesve për të paguar.
- ✓ Nga ana e Drejtorisë së audituar kishte kryer procedurë administrative për largimin e objektit . Drejtoria për punë inspektuese të jetë më e azhure në procedurat administrative për ndërmarrjen e masave në mos kryerjen e obligimeve nga ana e shfrytëzuesve ,

#### **KONKLuzioni**

Mos aplikimi i masave efektive nga ana e Drejtorisë përkatëse, rrit rrezikun që komuna të ketë një performancë të dobët në mbledhjen e të hyrave dhe mos realizim të projekteve që priten të financohen nga këto të hyra, si dhe rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme të komunës.

#### **4.4. MENAXHIMI I PROJEKTEVE**

Projektet janë mënyrë e veçantë e zhvillimit dhe formë e rëndësishme për realizimin e qëllimeve të definuara në planet zhvillimore të vendit, lokalitetit, kompanisë.

Projektet sigurojnë shfrytëzimin racional të fondeve dhe resurseve të rralla, i kontribuojnë rritjes së të ardhurave, qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe cilësisë më të mirë të jetesës përgjithësisht. Plotësimi i

këtyre objektivave kryesorë varët se në çfarë shkalle përmbushën parametrat e planifikuar të projektit. Një projekt është një detyrë unike, e përkohshme, komplekse dhe me qëllim të caktuar, me përshkrim të sakta të detyrave dhe resurse të definuara.

Menaxhimi i projekteve nënkupton planifikimin, përcjelljen, mbikqyrjen dhe drejtimin e një plani kompleks,

është një mënyrë e punës me plan, e orientuar kah qëllimi të cilin e ka përcaktuar porosidhësi.

Kërkohej të sigurohet një punë ekipore dhe mirë të koordinuar, menaxheri i projektit premtan përmbushje në afat të detyrave të projektit dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara.

Menaxhimi përmbledh arritjen e objektivave, ndjekjen e ecurisë së punës gjatë fazave të ndryshme të saj, dhe organizimin së bashku me ndarjen e detyrave.

Janë 5 (pesë) faza në menaxhimin e projektit- 1. Faza e definimit, 2. Faza e planifikimit, 3. Faza e organizimit, 4 faza e kontrollit, 5. Faza e përfundimit.

Çka është projekti në mënyrë më specifike? Është një përpjekje e përkohshme që ndërmerr të krijoj një produkt të veçantë, shërbim apo rezultat.

Një projekt është i përkohshëm që definon fillimin dhe përfundimin e kohës, po ashtu definon fusha dhe burime.

#### **Çështja 5 - Mos kryerja e projekteve dhe borgjet e mbetura.**

##### **Të Gjeturat**

###### **Në Vitin 2012**

- ✓ **NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATIN PATAQAN I POSHTËM DHE PATAQAN I EPËRM** - Ka vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/191/19, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 8.879,04€
- ✓ **NDËRTIMI I RRUGËS QARKORE NË RAHOVEC - PROJEKTI ËSHTË MBYLLUR NË VITIN 2019 PAS ZGJIDHJES SE PROBLEMEVE PRONESORE,** kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 416.615,61€.

###### **Në Vitin 2013**

- ✓ **NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN APTERUSHË DHE SEGMENTI I MBETUR NË RETIJË – Ritenderim** - Projekti është mbyllur teknikisht, ka mbetur pagesa e 10% e sigurimit pa paguar, , kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 33.825,02€
- ✓ **NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA BETONI NË FSHATIN FORTESË** - Ka vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/188/19, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 16.258,93€
- ✓ **NDËRTIMI I TROTUAREVE NË QYTETIN E RAHOVECIT** - Projekti është mbyllur, mirepo nuk kemi pranimit teknik ende, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 20.067,49€.
- ✓ **NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATIN XËRXË** - Ka vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/181/19, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 15.050,84€.

###### **Në Vitin 2015**

- ✓ **NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË FSHATIN PASTASEL** - Ka vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/193/19, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 8.048,94€.
- ✓ **NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË FSHATIN ZATRIQ** - Ka vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/193/19, kishte mbetur borgji sipas kontratës 12.500,11€, kishte mbetur borgji sipas kontratës në shumën prej 12.500,11€.
- ✓ **NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN VRAJAK, RATKOC, GEXHE, ZATRIQ, SAPNIQ**

DHE RETI E POSHTME - projekti kishte përfunduar, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 117.198,46€.

#### Në Vitin 2016

- ✓ NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS RETIJË – MAMUSHË – Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 9.999,58€.
- ✓ NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS RATKOC – BABOC - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 46.06,90€.
- ✓ NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS DRENOC – ZATRIQ - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 24.231,49 €.
- ✓ NDËRTIMI I SISTEMEVE TË UJËSJELLËSIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – ishte marveshja me Komunën dhe KRU. Gjakova, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 41.096,03€.
- ✓ NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS RAHOVEC - PATAQAN I POSHTËM – është duke vazhduar projekti, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 416.797,14€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE NË QYTETIN E RAHOVECIT – Kishte vendim për prerje të punimeve, vendimi nr.01/192/19, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 20.029,81€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE NË XËRXË, CELINË, NASHPALL, SENOC, RETIJË E EPËRME DHE MRASOR - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 49.702,25€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE NË HOÇË TË VOGËL, BRESTOC, KRUSHË TË MADHE DHE FORTESË - - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 103.988,20€.
- ✓ NDRIÇIMI PUBLIK DHE MIRËMBAJTJA E RRJETIT EKZISTUES - Projekti i përfunduar teknikisht, por i pa pranuar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 58.185,00€.
- ✓ NDËRTIMI DHE PËRMIRËSIMI I KANALIZIMIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 7.655,83€.

#### Në Vitin 2017

- ✓ NDËRTIMI I RRETH RROTULLIMIT TE JAHA PETROL NË RAHOVEC - Projekt i pa përfunduar, marreveshje me Ministrinë e Infrastruktura, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 39.062,46
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËS BRESTOC - HOQË E MADHE - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 1.844,30€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA NË DABIDOL, POLLUZHË, RATKOC, GEXHË, KRAMOVIK DHE GURI I KUQ - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 198.807,49€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE NË DRENOC, QIFLLAK, DEJNË, MALËSI E VOGËL DHE OPTERUSHË - Projekti i përfunduar teknikisht Shërbime Publike, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 103.195,85
- ✓ NDËRTIMI I RRETH RROTULLIMIT TE RRASAT DHE RIJA NË RAHOVEC - Projekt i pa përfunduar, marreveshje me Ministrinë e Infrastruktura, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 70.113,73€.
- ✓ NDËRTIMI I KANALIT PËR UJËRA ATMOSFERIK DHE NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA NË FSHATIN ZATRIQ - Projekt i papërfunduar, i planifikuar sivjet për të rifilluar punët, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 35.075,67€.
- ✓ INTERVENIMET EMERGJENTE NË INFRASTRUKTURË - Projekti i përfunduar

teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 54.672,71€.

- ✓ SHTRUARJA E RRUGËVE LOKALE ME KUBËZA NË FSHATIN RETIJË E POSHTME - Projekti i përfunduar teknikisht, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 3.479,58€.

Në vitin 2018

- ✓ NDËRTIMI I RRUGËS KRUSHË E MADHE – RANDOBRAVË - Projekt ne vazhdim te punimeve MI, eshte perfunduar sivjet ne maj 2019, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 192.997,89€.
- ✓ MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot I - Meremetimi i rrugëve me asfalt në Komunën e Rahoveci projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 149.418,40€.
- ✓ MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot II - Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza në Komunën e Rahovecit - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 61.973,51€.
- ✓ MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot III - Ndërtimin e mureve mbrojtëse- - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 128.110,00€.
- ✓ NDËRTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 131.701,10€.
- ✓ MIRËMBAJTJA E NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 108.526,00€.
- ✓ INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Loto I - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 6.709,28€.
- ✓ INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Loto II - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 18.049,56€.
- ✓ INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Loto III - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 15.233,76€.
- ✓ NDËRTIMI I RRUGËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Vazhdon projekti ne Pastasel, Polluzhe, Xerxe, Zaqisht, Rahovec etj.. kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 225.390,80€.
- ✓ NDËRTIMI I TROTUAREVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Projekti vazhdon ne Drenoc, Malesi e Vogel, Sapniq etj , kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 115.306,58€.
- ✓ NDËRTIMI I KANALIZIMEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 431.155,89€.
- ✓ MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE - Loto I - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 59.259,53€.
- ✓ MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE - Loto II - projekti vazhdon, kishte mbet borgji sipas kontratës në shumën prej 45.279,70€.

Në periudhën e parë të gjashtëmujorshit të vitit 2019, kishin filluar së punuari 14 (katërmëdhjet) projekte, në bazë të planifikimit të vitit 2019, ishin duke vazhduar.

Projektet e trashëguara nga viti 2012, një projekt kishte prerje te punimeve, vendimi nr.01/191/19, Kurse një projekt ishte mbyll në vitin 2019 pas zgjidhjes së problemeve pronësore.

Në vitin 2013 dy projekte ishin të përfunduara, njëri projekt ishte i pa pranuar teknikisht, dy projekte kishte prerje te punimeve, me anë të vendimit.

Në vitin 2015, dy projekte kishte prerje te punimeve, me anë të vendimit, kurse një ishte i përfunduar.

Në vitin 2016 ishin 7 (shtatë) të përfunduara, njëri projekt ishte i pa pranuar teknikisht, një projekt ishte ende duke vazhduar, një ishte me marrveshje kurse një Ka vendim per prerje te punimeve, me anë të vendimit nr.01/192/19

Në vitin 2017, ishin 5 (pesë) projekte të përfunduar, 3 (tre ) projekte në vazdim të pa përfunduara.



Në vitin 2018, ishin 14 (katërmëdhjet) projekte në vazhdim të pa përfunduara. Në 4(katër) projekte janë që vazhdojnë ende nga viti 2018-2019 dhe vazhdojnë në vitet tjera që janë projekte: për mirëmbajtjen e hapësirës publike, ndriqimi publik, meremetimi i rrugëve dhe trotuareve si dhe një projekt i stërzgatur nga vitet prapake që kanë qenë projekte me vlerë të vogël dhe kontrata me vlerë të mëdha.

Një projekt është në procedurë për vitin 2019.

Borgji total ishte 1.699.112,00€.

## KONKLUZIONI

Projektet jo të kryera është në kundërshtim me marrëveshjet, kalojnë përtej planifikimeve buxhetore dhe në mungesë të mjeteve, përcillen me implikime buxhetore për komunën e cila sfidohet me obligime të shumta pa mbështetje financiare me ndikim në vonesa të realizimit të projekteve.

## REKOMANDIMET:

### REKOMANDIMI – 1

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike.
- Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të marrë parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.
- Taksat për mbeturina të planifikuara të definojnë dhe të destinohen drejt, për inkasimin e të hyrave.

### REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.

### REKOMANDIMI - 3

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të shqyrtojë arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendosë masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të ndalojë shfrytëzimin e sipërfaqes publike që nuk është e përfshirë në kontratë.

### REKOMANDIMI - 4

- Rekomandojmë që Drejtoria përkatëse të insistojë në vendosjen e mekanizmave efikas për realizimin e të hyrave në përputhje me kushtet e kontraktuara, në të kundërtën të ndërmerren masa në bazë të ligjeve në fuqi.

### REKOMANDIMI – 5

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se projektet të kryhen në përputhje të plotë me marrëveshjet e bëra me palët e ndërlidhura me qëllim të evitimit të implikimeve financiare që shkaktohen më tej gjatë realizimit të tyre.

**PËRMBAJTJA E SHKURTËR DREJTUESE (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):**

**2. Fushëveprimi i këtij auditimi është :**

- Realizimi i të hyrave nga Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike dhe vendosja e objekteve të përkohshme për nëntëmujorshin të vitit 2018.


Në Drejtorin për Shërbime Publike, Komunale.

**3. Objektivat:**

1. Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake
  2. Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara.
  3. Taksat për vendosjen e objekteve të përkohshme (Baraka, kioska etj.)
  4. Taksat për dhënie me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzimin komercial.
- Menaxhimi i Projekteve

Binak Kryeziu

Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB



Smajl Latifi

Nënshkrimi i udhëheqësit-Sektorit i Subjektit Publik

